

VENDIM
Nr. 11, datë 6.2.2012

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 104, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 51 DATË 5.7.2010 PËR SHOQËRINË “WENERG” SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.2.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për ndryshimin e licencës nr. 104, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 51, datë 5.7.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wenerg” sh.a. plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15 pika 4 germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën me nr. 104, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Dardha 1” me fuqi 4 MW, të shoqërisë “Wenerg” sh.a., të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 51, datë 5.7.2010.

2. Fuqia e instaluar e hec “Dardha 1” nga 4 MW të bëhet 5.8 MW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani